

**VENDIM**  
**Nr. 146, datë 28.5.2026**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SHPK PËR MODIFIKIMIN E  
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1291/4 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1291 prot., datë 28.4.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim për modifikimin e licencës, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, në aneksin A të saj, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës.

- Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 11.1.2023 dhe kontratës me nr. 31 rep, nr. 13 kol., datë 27.1.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria është pajisur me të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi paraprak i dosjes ka rezultuar se shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit, si e tillë me *email*-in nr. 1291/1 prot., datë 5.5.2026, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i sjellë në vëmendje kryerjen e pagesës përkatëse.

- Rezulton se në datën 15.5.2026, shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores, si dhe ka shlyer pagesat e rregullimit.

- Po ashtu, me *email*-in e saj të datës 15.5.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/2 prot., datë 18.5.2026, shoqëria ka paraqitur disa saktësime/sqarime, në lidhje me aplikimin e saj, duke shtuar se kërkon të ndryshojë dhe numrin e paneleve, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

- Si e tillë, vlerësohet se afati për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë të fillojë nga kryerja e pagesës dhe paraqitjes së saktësimeve të objektit të kërkesës së saj.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “b”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa “c”, të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve të saj për ndryshimin e kërkuar në aneksin A të licencës.

- Po ashtu, në kuadër të një informacioni shtesë, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë që të depozitojë në ERE informacion mbi mënyrën se si parashikon të financojë investimin përkatës për vendosjen e këtyre veprave ndihmëse/njësive depozituese të energjisë elektrike.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw, duke ndryshuar numrin e paneleve dhe duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**